

SHPLLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE, LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Inspektor në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregjeve Prodhuese Kategoria e pagës III-a

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", te ndryshuar si dhe të Kreut II dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranim ne shërbimin civil për pozicionin:

- Inspektor në Drejtorinë e Mbikqyrjes se Tregjeve Prodhuese
- Kategoria e pagës III-a

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit ne shërbimin civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim ne shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave:

5 Mars 2018

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

Mbikqyrja dhe hetimi i kushteve të tregut për rastet e abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluar dhe përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve në tregjet prodhuese ku bëjnë pjesë dhe jo vetëm këto tregje prodhuese: energjia, gazi, karburantet, ndertimi etj.. Kryerja e vlerësimeve ligjore mbi aktet ligjore /ose nënligjore në fuqi të cilat mund të sjellin kufizime të konkurrencës në tregjet prodhuese që ai mbikëqyr.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-a),
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta per drejtesi dhe te zoteroje diplomë “Master ” në kete fushe.
- b) Të njohë programet kompjuterike per adminstrimin e bazës se te dhënave, strukture dhe analize te dhënash, mirëmbajtje dhe administrim rrjeti.
- c) Avantazh do të perbejnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë, por jo vetëm.
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit te Konkurrences ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 5 Mars 2018

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **07. Mars 2018**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit dhe ne ambientet e institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
- c) Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ” Për Mbrojtjen e Konkurrencës” te ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombetare e Konkurrences, Kodin e Procedurave Administrative
- d) *Për më shumë: www.caa.gov.al*

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrences do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të AK dhe në ambientet e AK, të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 22 të ligjit nr 152/2013 “Për nepunesit civil”, I ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të ketë përfunduar studimet e larta për Drejtesi dhe të zotërojë diplomë “Master” në këtë fushë.
- b. Të njohë programet kompjuterike për administrimin e bazës së të dhënave, strukturë dhe analizë të dhënash, mirëmbajtje dhe administrim rrjeti.
- c. Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë dhe jo vetëm.
- d. Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- e. Të zotërojë gjuhën angleze dhe një gjuhë e dytë e vendeve të BE përben avantazh.
- f. Të zotërojnë aftësi të punës në grup

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listes së notave;

c) fotokopje të librezës së punës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

d) Vertetimi gjendjes gjyqesore

dh) Numer kontakti dhe adrese vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me poste ose dorazi, *brenda datës 05.Mars 2018* në Autoritetin e Konkurrences me adrese: Rruga “Sami Frasheri”, kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrences, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrences duke filluar nga data 07.03.2018.